



Pranuar / Doretuar Primito / Pridato Received / Delivered	12	12	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Rr Prot Rr Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Basia Kolicina Quantity	
SKIMSHICK	7871	2022	115	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.902/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërja nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.902/2022 të datës 13.10.2022, të parashtruar nga ankuesi [redacted] të cilin me autorizim e përfaqëson [redacted] avokat nga Prishtina, kundër organit të punësimit Komunës së Shtimes, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 12.12.2022, mori këtë;

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.902/2022 e datës 13.10.2020, e parashtruar nga ankuesi [redacted]

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] ka qenë i punësuar në Komunën e Shtimes dhe së i njëjti ka ushtruar pozitën e punës Inspektor i Ndërtimit në Drejtorinë e Shërbimeve Publike. Me Aktvendimin 02-Nr.42 të datës 21.02.2019 të Kryetarit të Komunës së Shtimes është bërë pezullimi parandalues i ankuesit me 50% të pagës, për shkak së kundër të njëjtit është iniciuar procedurë penale si dhe është caktuar masa e sigurimit të paraburgimit, mbi bazën e dyshimit për kryerje të veprës penale gjatë ushtrimit të funksionit të tij.

Gjykata Themelore në Ferizaj-Departamenti për Krime të Rënda me Aktgjykimin PKR.42/2019 të datës 23.12.2019 ka shpallur fajtor ankuesin për vepër penale sipas nenit 442 paragrafi 1 të Kodit Penal, duke i shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti. Pas pranimit të Aktgjykimit PKR.42/2019 të datës 23.12.2019, Udhëheqësi i drejtpërdrejt i ankuesit ka iniciuar procedurë disiplinore ndaj ankuesit, ndërsa Komisioni Disiplinor i Komunës së Shtimes me Vendim me Nr.02/ID Nr.12 të datës 28.01.2020 ka shqiptuar ndaj ankuesit masën disiplinore "ndërprerje e marrëdhënia e punës pa dëmtuar apo reduktuar të drejtën në pension".



Me tej nga shkresat e lëndës Kolegji gjen së Gjykata e Apelit e Kosovës duke vendosur lidhur me ankesën e të dënuarit në këtë rast ankuesit, me Aktvendimin AKR.nr.83/2020 të datës 16.06.2020 ka anuluar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë PKR.42/2019 të datës 23.12.2019 dhe çështjen e ka kthyer në rigjykim dhe rivendosje, ndërsa Gjykata Themelore në Ferizaj-Departamenti për Krime të Rënda në ri-procedurë me Aktgjykimin me numër PKR.nr.105/20 të datës 21.06.2021 serish ka shpallur fajtor ankuesin për vepër penale sipas nenit 442 paragrafi 1 të Kodit Penal, duke e dënuar me burgim në kohëzgjatje prej 1 viti. Ankuesi në cilësi të të dënuarit, serish e kundërshton aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, kurse Gjykata e Apelit me Aktgjykimin me shenjën PKR.nr.295/21 të datës 15.09.2021 ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë duke i shqiptuar ankuesit dënim me burgim në kohëzgjatje prej tetë (8) muajve.

Kolegji i Këshillit po nga shkresat e lëndës veren se ankuesi kundër Vendimit m Nr.02/ID Nr.12 të datës 28.01.2020 të Komisionit Disiplinor kishte ushtruar ankesë në Komisionin për Zgjdhjen e Kontesteve dhe Ankesave (tutje KZKA) të Komunës së Shtimes i cili më Vendimin me Nr. 02/070/05/5626/29 të datës 01.04.2020 ka refuzuar ankesën si të pabazuar, ndërsa kundër vendimit të KZKA-së ankuesi më datë 02.05.2020 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës.

Me tej, sipas provave të kësaj çështje juridiko-administrative rezulton së Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, përmes shkresës me numër të protokollit 1540/2020 të datës 13.08.2020 ka njoftuar ankuesin se për shkak së Këshilli nuk është funksional (në mungesë të emërimit të anëtareve), nuk ka mundur të shqyrtoj ankesën e ankuesit të datës 05.02.2020 duke e udhëzuar të njëjtin që të filloj kontest administrativ në gjykatën kompetente, mirëpo bazuar në njoftimin e datës 08.12.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, konfirmohet se ankuesi nuk ka hapur konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:* Ankesën me numër të protokollit 6140/2022 të datës 13.10.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 09.09.2022; Formularin me numër 08/7 të datës 14.01.2020; Kërkesën për pezullim parandalues të datës 21.02.2019; Aktgjykimin me numër Ref. Nr GJ.A nr.21/20; Përgjigjen me numër 02/1-23 të datës 09.06.2020; Aktgjykimin me numër PKR.42/2019 të datës 23.12.2019; Aktvendimin me numër PAKR.nr.83/2020 të datës 16.06.2020; Aktgjykimin nën shenjën PKR 105/2020 të datës 21.06.2021; Aktgjykimin nën shenjën PAKR.nr.295/2021 të datës 15.09.2021; Kërkesën e datës 14.09.2022; Dëftesën për pranimin e dërgesës të datës 14.09.2022; Përgjigjeni në kërkesë me numër 02/1-130 të datës 26.09.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 6281/2022 të datës 18.10.2022; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 6371/2022 të datës 21.10.2022; Shkresë emërimit me numër të protokollit 02/1/12 të datës 31.01.2011; Aktvendimin me numër 02-Nr.42 të datës 21.02.2019; Aktgjykimin nën shenjën PKR.nr.42/2019 të datës 23.12.2019; Vendimin me numër Nr.02/ID Nr.12 të datës 28.01.2020; Vendimin me numër të protokollit 02/1-121 të datës 08.09.2014 për shqiptimin e masës disiplinore largim nga puna; Aktvendimin nën shenjën PN1.nr.406/19 të datës 12.04.2019; Aktvendimin nën shenjën PAKR.nr.83/2020; Aktgjykimin nën shenjën PKR 105/20 të datës 21.06.2021; Aktgjykimin nën shenjën PAKR.nr.295/21; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 24.12.2018; Përshkrimin e detyrave të punës të datës 29.05.2015; Aktvendimin me numër 583 të datës 22.10.2018 për emërimin e Komisionit për



Konteste dhe Ankesa; Aktvendimin me numër protokollit 584 të datës 22.10.2018 për themelimin e Komisionit Disiplinore; Ankesën e ankuesit datës 08.05.2020 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Ftesën me numër 9 të datës 14.01.2020 për intervistim për shkelje disiplinore të supozuar; Formularin me numër 08/7 të datës 14.01.2020 për raportimin e shkeljes disiplinore; Shkresë me numër reference 06/1-2/014-2019 të datës 25.02.2019; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 994/2020 të datës 01.06.2020; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 1118/2020 të datës 09.06.2020; Procesverbalin e datës 17.01.2020; Njoftimin me numër A/02/1-24 të datës 05.03.2020 për korrigjimin plotësimin e ankesës; Ankesën e datës 03.03.2017 drejtuar Komisionit të ankesave në Komunën e Shtimes; Fletedorzimin e datës 01.04.2020; Vendimin me numër 02/070/05/5626/29 të datës 01.04.2020; Shkresën me numër 02/ID/12/1 të datës 30.01.2020 lidhur me shënimin zyrtar; Fletedorzimin e datës 28.01.2020; Vendimin nën shenjë VK.nr.166/2022 të datës 23.11.2022 të Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, shkresës me numër të protokollit 1540/2020 të datës 13.08.2020 të KPMSHC-së lidhur me njoftimin e ankueses par shqyrtim të ankesës, e-mailin me numër protokollit 7794/22 i datës 08.12.2022 nga Gjykata Themelore në Prishtinë drejtuar KPMSHC.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha provat së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se janë të pabazuara pretendimet ankimore të ankuesit, *SEPSE*:

Kolegji i Këshillit nga shqyrtimi i provave të administruar konstatoi se ankuesi më datë 14.09.2022 ka parashtruar kërkesë të Kryetari i Komunës së Shtimes për kompensimin e 50% të pagës për periudhën nga data 18.01.2020 deri me datën 15.09.2021, ndërsa ky i fundit përmes përgjigjes në kërkesë të datës 26.09.2022 ka njoftuar ankuesin se Vendimi me numër 02/070/05/5626/29 i datës 01.04.2020 i Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave është ende në fuqi dhe se jemi në pritje të një përgjigje nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se Komisioni Disiplinor me Vendimin Nr.02/ID Nr.12 të datës 28.01.2020 me rastin e ndaljes së tërësishme të pagës së ankuesit pa pasur vendim përfundimtar të gjykatës, ka vepruar në kundërshtim me nenin 69 paragrafi 2 dhe neni 63 paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke kërkuar që Këshilli ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe të obligoj Drejtorinë për Financa në Komunën e Shtimes që ankuesit ti kompensoj 50% të pagave të paguara për periudhën kohore nga data 28.01.2020 deri me 18.09.2021.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit i'u referua dispozitave të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës i zbatueshëm në kohën nxjerrjes së Vendimit Nr.02/ID Nr.12 të datës 28.01.2020 të Komisionit Disiplinor dhe Vendimit Nr. 02/070/05/5626/29 të datës 01.04.2020 të KZKA-së, përkatësisht nenit 82 paragrafi 1 dhe 2 të këtij ligji më të cilin përcaktohej se: *Komisionet për zgjidhjen e kontesteve dhe të ankesave themelohen në kuadër të çdo institucioni të administratës qendrore dhe komunale, si organe për zgjidhjen e kontesteve dhe pranimit të ankesave. 2. Vendimet e komisioneve për zgjidhjen e kontesteve dhe të ankesave janë të detyrueshme për institucionet e administratës publike dhe për të gjitha palët përkatëse. Kundër vendimeve të tyre mund të paraqitet ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës. Ndërlidhur me këtë, Rregullorja Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave gjegjësisht neni 10 i kësaj rregullore ka përcaktuar se: *Institucioni përkatës është përgjegjës për zbatimin e vendimit të**





*Komisionit, në pajtim me paragrafin 2 të nenit 82 të Ligjit.*", ndërsa neni 11 i po të të njëjtës rregullore ka përcaktuar se: " *Kundër vendimit të Komisionit, palët e pakënaqura kanë të drejt ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, brenda afitit prej 30 ditësh*". Rrjedhimisht, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore, e në mbështetjeje të shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit konstaton së ankuesi kundër Vendimit të Komisionit Disiplinor me numër Nr.02/ID Nr.12 të datës 28.01.2020, ka parashtruar fillimisht ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Shtimes, e më pastaj në Këshillin e Përvarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil (si organ i shkallës së dytë në procedurë administrative), mirëpo i njëjti edhe përkundër njoftimit të Këshillit së ankesa e tij nuk mund të shqyrtohet për shkak të mos emërimit të anëtareve, ankuesi nuk ka hapur konflikt administrativ në gjykatën kompetente.

Përkitazi me të drejtën e fillimit të konfliktit administrativ ndaj akteve të nxjerra në procedurë administrative, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, gjegjësisht nenin 14 të këtij ligji me të cilin është përcaktuar se: " *Konflikti administrativ mund të fillojë edhe kur organi kompetent nuk ka nxjerrë akt përkatës administrativ sipas kërkesës ose ankesës së palës, nën kushtet e parashikuara me këtë ligj*" si dhe nenin 28 paragrafi 1 po të të njëjtit ligj me të cilin është paraparë se: " *Nëse organi i shkallës së dytë nuk e ka nxjerrë vendimin brenda tridhjetë (30) ditësh ose në një afat më të shkurtër të caktuar me dispozita të veçanta rreth ankimit të palës kundër vendimit të organit të shkallës së parë, ndërsa nuk e nxjerr as në afatin e mëtejshëm prej shtatë (7) ditësh me kërkesë të përsëritur, pala mund të fillojë konfliktin administrativ sikur t'i është refuzuar ankesa*", rrjedhimisht nisur nga ky përcaktim ligjor rezulton së ankuesi edhe në mungesë të vendimit të Këshillit si organ i shkallës së dytë, mund të fillonte konflikt administrativ në gjykatën kompetente kundër aktit me të cilin pretendon së i janë shkelur dhe cenuar të drejtat tij nga marrëdhënia e punës.

Andaj, duke marrë parasysh së pretendimet ankimore të ankuesit bazohen në paligjshmërinë e Vendimit Nr.02/ID Nr.12 të datës 28.01.2020 të Komisionit Disiplinor si dhe duke qenë së ankuesi nuk ka hapur konflikt administrativ pranë gjykatës kompetente pas heshtjes së Këshillit lidhur me ankesën e ankuesit të datës 02.05.2020 të parashtruar kundër Vendimit Nr.02/070/05/5626/29 të datës 01.04.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, Kolegji mbi bazën e këtyre rrethanave ligjore, e në kuptim të dispozitave të nenit 51 paragrafi 3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative më të cilin është përcaktuar se: *Një akt administrativ do të prodhojë pasojë juridike për aq kohë sa nuk është anuluar apo shfuqizuar sipas detyrës zyrtare apo si rezultat i ushtrimit të mjeteve juridike administrative apo gjyqësore, nuk skadon për arsye të kohës apo përmbushjes së qëllimit të tij, apo nuk pushon së prodhuari të pasojave, për çfarëdo arsye tjetër të paraparë me ligj*", vlerëson së në mungesë të ndër marrjes së mjeteve juridike për kundërshtim të ligjshmërisë, Vendimi Nr.02/070/05/5626/29 i datës 01.04.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave është vendim përfundimtar/ekzekutueshëm lidhur me këtë çështje juridiko-administrative, dhe se shqyrtimi i ligjshmërisë së tij në kuptim të themelësisë së pretendimeve ankimore është i pamundur ligjërisht në këtë procedurë ankimore, e si rrjedhojë Kolegji konstaton së pretendimet ankimore të ankuesit nuk janë të drejta dhe të bazuara.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1, nenit 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe



nenit 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nNr.902/2022

**Ilire Mehmeti-Shaqiri**

  
Procesmbajtëse

**Ardita Haxhnikaj-Demi**

  
Kryetare e Kolegjit

**Vendimi dërgohet për:**

- Përfaqësuesin e ankuesit me autorizim avokal [REDACTED]
- Kryetarin e Komunës së Shtimes; ;
- Udhëheqësin e Personelit në Komunën e Shtimes; dhe
- Arkivin e KPMSHCK-së